

FONDI I INVESTIMIT “ABI FLEX USD”

Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit të
Pavarur Më dhe për vitin e mbyllur më 31
dhjetor 2025

Përmbajtja

	Faqe
Pasqyra e Pozicionit Financiar	1
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Aktivet Neto	3
Pasqyra e Flukseve të Parasë	4
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare	5-25
Skedule Suplementare	I-VIII



RSM ALBANIA
Rr.Skender Luarasi, sheshi Gjenerali
Jozef San Martin, Pallati 3Hyrja 19,
Tiranë, Shqipëri
T: +355 69 706 6110
www.rsm.global/albania

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe Personat e Ngarkuar me Qeverisjen e Fondit të Investimit "ABI FLEX USD" dhe shoqërisë administruese të fondeve "ABI Invest" sh.a.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondit të Investimit "ABI FLEX USD" ("Fondi i Investimit"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2025, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, si dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe të fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël materiale.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit të Investimit më 31 dhjetor 2025, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Fondi i Investimit në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës të Kontabilistëve Profesionistë (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i BSNEKP) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEKP.


Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje tjetër

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 janë audituar nga një auditues tjetër, i cili ka shprehur një opinion pa rezerva mbi ato pasqyra financiare më 30 prill 2025.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
ASSURANCE | TAX | CONSULTING

RSM Albania SH.P.K is part of the RSM network and trades as RSM. RSM is the trading name used by the members of the RSM network. Each member of the RSM network is an independent accounting and consulting firm, which practices in its own right. The RSM network is not itself a separate legal entity in any jurisdiction.



Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Fondit të Investimit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Fondin e Investimit ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit të Investimit.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq-përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Fondit të Investimit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Fondit të Investimit për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Fondi i Investimit të ndalojë së vazhduari në vijimësi.



- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e Fondit të Investimit, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Raport për Informacione të Tjera

Informacione të tjera përfshijnë informacione përgatitur në përputhje me Ligjin Nr. 25/2018 Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera të Fondit të Investimit për vitin 2025 priten të na vihen në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomalitë materiale. Nëse bazuar në punën e kryer ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë gabime materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Nëse arrijmë në përfundimin se ka një gabim material në të, ne jemi të detyruar t'ua komunikojmë çështjen atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen.

Bujar Bendo
Auditues Ligjor

RSM Albania

Tiranë, 24 prill 2026



FONDI I INVESTIMIT "ABI FLEX USD"**Pasqyra e Pozicionit Financiar***(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)*

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
AKTIVE			
Mjete monetare dhe ekuivalentë	7	12,711,326	14,920,456
Investime në letra me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse	8	52,427,105	50,246,917
Llogari të arkëtueshme		157,308	216,241
TOTALI I AKTIVIT		65,295,739	65,383,614
DETYRIME			
Detyrime ndaj shoqërisë administruese	9	(207,499)	(107,848)
Detyrime të tjera	10	(244,486)	(2,099,998)
TOTALI I DETYRIMEVE		(451,986)	(2,207,845)
VLERA NETO E AKTIVEVE		64,843,753	63,175,769
Gjendja e numrit të kuotave të fondit		6,886	6,345
AKTIVET NETO PËR KUOTË TË FONDIT TË INVESTIMIT		9,416.7505	9,957.2340

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 24, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga drejtimi i Shoqëria Administruese e Fondeve "ABI Invest" Sh.a., më 31 Mars 2026 dhe janë firmosur nga:

Niko Kotonika

Administratori i Përgjithshëm



FONDI I INVESTIMIT “ABI FLEX USD”**Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse***(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Të ardhura të tjera nga interesa të tjera	12	972,743	1,350,779
Të ardhura nga dividendët		165,616	199,738
Të ardhura të tjera		21,306	491
		1,159,665	1,551,008
Tarifa për Shoqërinë Administruese	13	(1,215,816)	(1,197,847)
Tarifa për depozitarin	14	(138,693)	(131,920)
Shpenzime të tjera	15	(478,550)	(380,859)
		(1,833,059)	(1,710,626)
Fitim të perealizuara nga maturimi i investimeve dhe të tjera	11	4,147,809	1,871,344
(Humbje) / Fitim të realizuara nga shitja e investimeve dhe të tjera		(1,036,676)	452,474
(Humbje)/ Fitim nga ndryshimi në kursin e këmbimit	16	(5,887,868)	322,406
		(2,776,735)	2,646,223
		(3,450,129)	2,486,605
(Humbje)/Fitim neto nga investimet		(3,450,129)	2,486,605
(Zvogëlim) / Rritja i/(e) aktiveve neto nga veprimtaria e fondit		(3,450,129)	2,486,605

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 24, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

FONDI I INVESTIMIT "ABI FLEX USD"
Pasqyra e Ndryshimeve në Aktivet neto

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Numri i kuotave në numër	Aktivitet e Fondit të Investimit në lekë	Vlera Neto e Aktiveve për Kuotë në lekë/ Kuotë
Gjendja më 1 janar 2024	5,742	54,801,568	9,544.1255
Kontribute të hyra nga anëtarët e Fondit	660	6,436,407	-
Tërheqje nga Fondi	57	548,812	-
Humbja neto nga investimet	-	2,486,605	-
Rënia totale në aktivet neto	603	8,374,201	-
Gjendja më 31 dhjetor 2024	6,345	63,175,769	9,957.2340
Kontribute të hyra nga anëtarët e Fondit	541	5,118,113	-
Tërheqje nga Fondi	-	-	-
Humbja neto nga investimet	-	(3,450,129)	-
Rënia totale në aktivet neto	541	1,667,984	-
Gjendja më 31 dhjetor 2025	6,886	64,843,753	9,416.7505

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 24, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

FONDI I INVESTIMIT “ABI FLEX USD”**Pasqyra e Flukseve Monetare***(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)*

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2024
Flukset e parasë nga aktiviteti operacional			
Rënia e vlerës së aktiveve neto		87,875	(2,486,605)
Rregullime për: (Humbje)/Fitim të realizuara nga shitja e investimeve në letra me vlerë përmes fitimit ose humbjes	11	-	(2,646,223)
Flukset e parasë nga aktiviteti operacional		87,875	(5,132,828)
Rregullime për kapitalin punues:			
Blerje e aktiveve financiare të mbajtura për shitje	8	-	(45,504,582)
Shitje e aktiveve financiare të mbajtura për shitje	8	-	2,646,223
Maturimi i aktiveve financiare të mbajtur për shitje		-	31,841,157
Rritja në detyrimet ndaj shoqërisë administruese		(315,347)	15,526
Rritja në detyrimet të tjera	10	(432,415)	1,921,518
Flukset e parasë të përdorura në aktivitetet operacionale		(747,762)	(9,080,158)
Flukset e parasë nga aktiviteti financues			
Hyrje nga emetimi i kuotave		-	6,436,407
Dalje për shlyerjen e kuotave		-	548,812
Flukset e parasë të gjeneruara nga aktiviteti financues		-	6,985,219
(Rënia)/Rritja në mjetet monetare dhe ekuivalentë të saj		(2,209,130)	3,037,890
Mjete monetare dhe ekuivalentë të saj në fillim të periudhës		14,920,456	11,882,566
Mjete monetare dhe ekuivalentë të saj në fund të periudhës	7	12,711,326	14,920,456

Pasqyra e flukseve të parasë duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 24 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Fondi i Investimit "ABI FLEX USD" (në vijim: Fondi) është një Sipërmarrje Investimesh Kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, e veçantë, e themeluar nga ABI INVEST sh.a. (në vijim: Shoqëria Administruese), shoqëri administruese e licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare më datë 27 shkurt 2020 (në vijim: 'AMF'), për të administruar Sipërmarrje të Investimeve Kolektive.

ABI Invest sh.a. është një institucion financiar i licencuar si Shoqëri Administruese e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive bazuar në ligjin 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive"

Fondi u licencua më datë 30.03.2021 nga Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, me anë të vendimit të Bordit nr. 112 nën administrimin e shoqërisë ABI Invest sh.a, ndërkohë ai ka filluar mbledhjen e ofertave fillestare gjatë muajit tetor 2021 dhe veprimtarinë me çmim të ndryshueshëm më 18 nëntor 2021.

Mbështetur në Ligji nr. 56/2020, datë 30.04.2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka miratuar Banka e Parë e Investimeve Shqipëri Sha si bankë depozitare e Fondit të Investimit ABI FLEX USD. Me vendim nr. 121, datë 26.08.2025 Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka miratuar zëvendësimin e Bankes depozitare Banka e Parë e Investimeve Shqipëri Sha me Credins Bank.

Shoqëria dhe Depozitari janë të detyruara të mbajnë të ndara aktivet, veprimet dhe regjistrimet e veta, nga aktivet, veprimet, dhe regjistrimet e Fondit, për këtë arsye edhe raportimet për shoqërinë dhe Fondin paraqiten të ndara.

Kthimi historik i Fondit që nga themelimi deri në 31.12.2025 është 14.2% dhe gjatë vitit të fundit të plotë kalendarik 8.11%.

Aktivët e fondit investohen në përputhje me dispozitat dhe parashikimet e ligjit nr. 56/2020, datë 30.04.2020 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive". Investitorët ose mbajtësit e kuotave kanë të drejtë të marrin pjesë në mënyrë proporcionale në fitimet e fondit, si dhe të kërkojnë, në çdo kohë, shlyerjen e plotë ose të pjesshme të kuotave që zotërojnë.

2. Bazat e përgatitjes

2.1 Bazat e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Kuadri kontabël i aplikuar është i bazuar në politikat kontabël të listuara në shënimin nr. 3, të cilat janë të bazuara në vlerësimin, paraqitjen, dhe parimet kontabël sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Më poshtë paraqiten parimet kryesore të politikave kontabël të aplikuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)**2.2 Bazat e matjes**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike përveç letrave me vlerë të mbajtura për tregtim, të cilat janë paraqitur me vlerën e drejtë.

2.3 Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në monedhën shqiptare "Lek", e cila është monedha funksionale, përveç rasteve kur është shënuar ndryshe.

2.4 Paraqitja e pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të supozimit të vijimësisë. Menaxhimi i Fondit ka bërë një vlerësim të aftësisë së saj për të operuar në vijimësi dhe është e konfident që ka burime për të vazhduar në të ardhmen e parashikuar. Për më tepër, drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale, që mund të hedh dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Fondit për të vazhduar në vijimësi. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të jenë të përgatitur në bazë vijimësie.

2.5 Përdorimi i vlerësimit dhe i gjykimit profesional

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të vlerësuara. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periodhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periodhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Aktivitetet e fondit janë të gjitha të investuara sipas Prospektit në Tituj Borxhi të emetuara nga Qeveri Qendrore apo Korporative, Aksione, ETFs si dhe në depozita me banka.

Ndikimi i përgjithshëm i situatës së tregjeve ndërkombëtare për vitin 2025 ka përgjithësisht pozitiv për Fondin, duke sjellë një rritje të normës së kthimit nga kuota në nivelin 8.11% për vitin e plotë kalendarik të mbyllur 2025 (kthimi historik është kthyer pozitiv nga themelimi prej 14.2%).

Në zbatim të Rregullores së Autoritetit, Shoqëria ka kryer teste të rezistencës për Fondin e Investimeve, ndikimin e skenarëve të ndryshëm në aktivet e Fondit si rezultat i ndryshimit të ndjeshëm të normave të interesit, si dhe ndikimin në vazhdimësinë e Fondit të Investimeve.

Më poshtë paraqitet ecuria e treguesve kryesorë të Fondit të Investimeve gjatë vitit të mbyllur financiar 2025.

Ecuria e aseteve të Fondit dhe kthimi nga investimi

Fondi i investimeve ka pasur një rritje të aktiveve neto gjatë vitit me 17.33%, ndërkohë që nga fillimi raporton rritje të aktiveve neto me rreth 57.27%.

Kjo përbën një performancë historike dhe jo një premtim apo garanci për kthimet në të ardhmen. Në periodha afatshkurtra. Çdo investitor mund të ndjekë ecurinë ditore të Fondit dhe Shoqëria publikon periodikisht të dhënat financiare të Fondit.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

2.5 Përdorimi i vlerësimit dhe i gjykimit profesional (vazhdim)

Ecuria e likuiditetit

Mjetet likuide në varësi të përfitueshmërinë dhe tregut mund të mbahen të lira në llogari ose të investohen në depozita afatshkurtra, në përputhje me kuadrin rregullativ dhe limitet respektive.

Në përputhje dhe me raportimet periodike në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, Rezerva e Likuiditetit është mbajtur mbi vlerën më të lartë mes nivelit 10% dhe totalit të tërheqjeve neto për tre-mujor. Pra, niveli i Rezervës ka qenë i mjaftueshëm në çdo moment për të administruar kërkesat për shlyerje sikundër edhe përmbushjen e detyrimeve rregullatore.

3. Përmbledhje e politikave kontabël

Politikat kontabël të përmendura më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente nga Fondi në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare.

3.1 Mjete monetare dhe ekuivalentë me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to përfshijnë gjendjet monetare në arkë, paratë e vendosura në banka dhe investime mjaft likuide afat-shkurtra me maturitet më pak ose deri në tre muaj nga momenti i blerjes.

3.2 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit këmbehen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit të asaj date. Fitimi ose humbja nga kurset e këmbimit për zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhë funksionale në fillim të vitit dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të këmbyerë me kursin e këmbimit në fund të vitit.

Aktivët dhe detyrimet jo-monetare të nominuara në monedhë të huaj të cilat maten me vlerë të drejtë këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilën është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë në monedhë të huaj të cilat maten me kosto historike këmbehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Kurset e këmbimit zyrtare bankare të zbatuara sipas Bankës së Shqipërisë (Lekë kundrejt njësisë së monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
EUR	96.77	98.15
USD	81.64	94.26

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.3 Standardet dhe amendimet e reja ose të ndryshuara

3.3.1 Standardet e reja dhe të rishikuara të cilat janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2025

Disa standarde të kontabilitetit që kanë hyrë në fuqi nga 1 janari 2025 dhe që kanë qenë të miratuara, nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në rezultatet financiare ose pozicionin financiar të Fondit. Për këtë arsye, informacioni shpjegues në lidhje me këto standarde nuk është dhënë në pasqyrat e Fondit.

Standarde, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që janë efektive për herë të parë në vitin 2025 dhe që mund të zbatohen nga Fondi janë:

- Mungesa e shkëmbimit (Ndryshimet në SNK 21)

Këto ndryshime nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në këto Pasqyra Financiare dhe për këtë arsye nuk është bërë dhënia e informacioneve shpjeguese.

3.3.2 Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende efektive dhe nuk janë miratuar më parë nga Shoqëria

Standarde dhe amendamente të tjera që nuk janë ende efektive dhe nuk janë miratuar më herët nga Shoqëria përfshijnë:

- Ndryshime në Klasifikimin dhe Matjen e Instrumenteve Financiare (Ndryshime në SNRF 9 dhe 7)
- SNRF 18 "Prezantimi dhe shpalosja në pasqyrat financiare"
- SNRF 19 'Filiale pa Përgjegjësi Publike: Dhënia e informacioneve shpjeguese'

Këto ndryshime nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në këto Pasqyra Financiare dhe për këtë arsye nuk është bërë dhënia e informacioneve shpjeguese.

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, janë publikuar nga IASB ose IFRIC: disa standarde të reja por ende jo efektive, disa ndryshime dhe shtesa në Standardet ekzistuese, si dhe disa Interpretime. Asnjë nga këto standarde apo ndryshime në standardet ekzistuese nuk janë adoptuar më herët nga Fondi dhe nuk janë lëshuar Interpretime që janë të zbatueshme apo që duhet të merren në konsideratë në datën e raportimit nga Fondi.

Drejtimi parashikon që të gjitha njoftimet e rëndësishme do të miratohen për herë të parë për periudhën që fillon në ose pas datës efektive të njoftimit. Standardet e reja, ndryshimet dhe Interpretimet e pa adoptuara në vitin aktual nuk janë shpalosur pasi ato nuk pritet të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Fondit.

Menaxhimi parashikon që të gjitha standardet përkatëse do të miratohen për periudhën e parë duke filluar në ose pas datës efektive të shpalljes. Standardet e reja, amendamentet dhe interpretimet që nuk janë miratuar në vitin aktual nuk janë përfshirë në informacionin shpjegues pasi nuk pritet të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Fondit.

3.4 Instrumentat Financiare

3.4.1 Njohja dhe çregjistrimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare njihen kur Shoqëria bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit financiar.

Aktivitet financiar çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar, ose kur aktivitet financiar transferohen dhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet transferohen.

Një detyrim financiar çregjistrohet kur shuhet, shlyhet, anulohet ose skadon.

3.4.2 Klasifikimi dhe matja fillestare e aktiveve financiare

Përveç atyre të arkëtueshme tregtare që nuk përmbajnë një përbërës të konsiderueshëm financimi dhe maten me çmimin e transaksionit në përputhje me SNRF 15, të gjitha aktivitet financiar fillimisht maten me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit (aty ku është e aplikueshme).

Aktivitet financiar, të ndryshme nga ato të përcaktuara dhe efektive si instrumenta mbrojtës, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- Me kosto të amortizuar
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVTPL)
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI).

Klasifikimi përcaktohet nga:

- modeli i biznesit i njësisë ekonomike për menaxhimin e aktivitet financiar
- karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivitet financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me aktivitet financiar që njihen në fitim ose humbje paraqiten brenda shpenzimeve financiare, të ardhurave financiare ose zërave të tjerë financiarë, me përjashtim të shpenzimeve të zhvlerësimit të arkëtueshmeve tregtare të cilat përfshihen brenda shpenzimeve të tjera.

3 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.4 Instrumentat Financiare (vazhdim)

3.4.3 Matja e mëpasshme e aktiveve financiare

i) Aktivet financiare me kosto të amortizuar

Aktivët financiarë maten me koston e amortizuar nëse plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk janë paracaktuara si FVTPL):

- ato mbahen në kuadër të një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e mjeteve financiare dhe mbledhja e flukseve monetare kontraktuale
- kushtet kontraktuale të aktiveve financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar

Pas njohjes fillestare, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, dhe të arkëtueshmeve të tjera, të cilët më parë ishin klasifikuar si të mbajtura deri në maturim, sipas SNK 39, bëjnë pjesë në këtë kategori të instrumenteve financiare.

ii) Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL)

Aktivët financiarë që mbahen në një model biznesi të ndryshëm nga "mbajtja për të mbledhur" ose "mbajtja për të mbledhur dhe shitur" kategorizohen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes. Më tej, pavarësisht nga modeli i biznesit, aktivët financiarë, flukset monetare kontraktuale të cilave nuk janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit klasifikohen në kategorinë FVTPL. Të gjitha instrumentet financiare derivative bien në këtë kategori, përveç atyre të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtës, për të cilët zbatohen kërkesat e kontabilitetit mbrojtës (shih më poshtë).

Kjo kategori gjithashtu përmban një investim në kapital. Aktivët në këtë kategori maten me vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje.

Vlera e drejtë e aktiveve financiare në këtë kategori përcaktohet duke iu referuar transaksioneve aktive të tregut ose duke përdorur një teknikë vlerësimi ku nuk ekziston një treg aktiv. Sipas kërkesave të SNRF 9 nuk lejohet mbajtja me kosto e këtyre aktiveve.

3 Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.4 Instrumentat Financiare (vazhdim)

3.4.4 Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 përdorin më shumë informacione të ardhshme për të njohur humbjet e pritshme të kreditit - 'modelin e humbjeve të pritshme të kreditit (ECL)'.

Instrumentet financiare në kuadër të kërkesave të reja përfshinin kreditë dhe aktivet e tjera financiare të borxhit të matura me koston e amortizuar, llogaritë e arkëtueshme, aktivet financiare të matura me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, aktivet e kontraktuara të njohura dhe të matur sipas SNRF 15 dhe angazhimeve të huasë dhe disa kontratave të garancisë financiare (për emetuesin) që nuk maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Njohja e humbjeve të kreditit nuk varet me prej identifikimit të një ngjarje individuale të humbjes së kredisë mbi baze individuale. Në vend të kësaj, Fondi konsideron një gamë më të gjerë informacioni gjatë vlerësimit të rrezikut të kredisë dhe matjen e humbjeve të pritshme të kreditit, duke përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetura që ndikojnë në arkëtueshmërinë e pritshme të flukseve monetare të ardhshme të instrumentit.

Në zbatimin e kësaj qasjeje të ardhshme, bëhet një dallim midis:

- instrumentet financiare që nuk janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare ose që kanë rrezik të ulët të kredisë ('Faza 1') dhe
- instrumentet financiare që janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare dhe rreziku i kredisë i të cilit nuk është i ulët ('Faza 2').

'Faza 3' do të mbulonte aktivet financiare që kanë tregues objektive të zhvlerësimit në datën e raportimit.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.4 Instrumentat Financiare(vazhdim)

3.4.4 Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

Humbjet e pritshme të kreditit '12 - mujore' njihen për kategorinë e parë, ndërsa 'humbjet e pritshme të kreditit përgjatë jetës së instrumentit' njihen për kategorinë e dytë.

Matja e humbjeve të pritshme të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kredisë gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar. Fondi nuk ka identifikuar dhe njohur zhvlerësim për aktivet financiare më 31 dhjetor 2025.

Klasifikimi dhe matja e detyrimeve financiare

Detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë dhe, kur është e aplikueshme, përshtaten për kostot e transaksionit, përveç nëse Grupi ka përcaktuar një detyrim financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Më pas, detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç derivativave dhe detyrimeve financiare të përcaktuara në FVTPL, të cilat mbahen më pas me vlerën e drejtë me fitimet ose humbjet të njohura në fitim ose humbje (përveç instrumenteve financiare derivative të cilat janë të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse).

Të gjitha pagesat lidhur me interesin dhe, nëse është e zbatueshme, ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti që raportohen në fitim ose humbje përfshihen në kostot financiare ose të ardhurat financiare.

3.4.5 Instrumentet financiare derivative dhe kontabiliteti mbrojtës

Instrumentet financiare derivative llogariten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes (FVTPL) me përjashtim të derivateve të përcaktuara si instrumente mbrojtës në marrëdhëniet mbrojtëse të flukseve monetare, të cilat kërkojnë një trajtim të veçantë kontabël. Për t'u kualifikuar për kontabilitetin mbrojtës, marrëdhënia mbrojtëse duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e mëposhtme:

- Ekziston një marrëdhënie ekonomike midis zërit të mbrojtur dhe instrumentit mbrojtës
- Efekti i rrezikut të kredisë nuk dominon ndryshimet e vlerës që rezultojnë nga ajo ekonomike
- Raporti i mbrojtjes i marrëdhënies mbrojtëse është i njëjtë me atë që rezulton nga sasia e elementit të mbrojtur që njësia ekonomike aktualisht mbron dhe sasia e instrumentit mbrojtës që njësia ekonomike aktualisht përdor për të mbrojtur atë sasi të elementit të mbrojtur.

Të gjitha instrumentet financiare derivative të përdorura për kontabilitetin mbrojtës njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe raportohen më pas me vlerën e drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar.

Në masën që mbrojtja është efektive, ndryshimet në vlerën e drejtë të derivativëve të përcaktuar si instrumente mbrojtës në mbrojtjen e fluksit të mjeteve monetare njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe përfshihen në rezervën mbrojtëse të fluksit të mjeteve monetare në kapitalin neto. Çdo inefiçensë në marrëdhënien mbrojtëse njihet menjëherë në fitim ose humbje.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.4 Instrumentat Financiare(vazhdim)

3.4.5 Instrumentet financiare derivative dhe kontabiliteti mbrojtës (vazhdim)

Në kohën kur elementi i mbrojtur ndikon në fitimin ose humbjen, çdo fitim ose humbje e njohur më parë në të ardhurat e tjera përmbledhëse riklasifikohet nga kapitali neto në fitim ose humbje dhe paraqitet si një riklasifikim brenda të ardhurave të tjera përmbledhëse. Megjithatë, nëse një aktiv ose detyrim jo financiar është njohur si rezultat i transaksionit të mbrojtur, fitimet dhe humbjet e njohura më parë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse përfshihen në matjen fillestare të elementit të mbrojtur.

Nëse një transaksion i ardhshëm nuk pritet të ndodhë, çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse bartet menjëherë në fitim ose humbje. Nëse marrëdhënia mbrojtëse pushon të përmbushë kushtet e efektivitetit, kontabiliteti mbrojtës ndërpritet dhe fitimi ose humbja në fjalë mbahen në rezervën e kapitalit neto derisa të ndodhë transaksioni i ardhshëm.

3.5 Depozita me afat

Depozitat me afat paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar në shumën e principalit dhe klasifikohen si të tilla ato me maturitet më shumë se tre muaj. Interesi përlllogaritet në bazë rritëse dhe interesi i arkëtueshëm pasqyrohet në të arkëtueshme të tjera.

3.6 Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen në fillim me vlerën e drejtë dhe maten në vazhdim me kosto të amortizuar.

3.7 Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme mbahen me kosto të amortizuara.

3.8 Vlera neto e aktiveve të Fondit

Vlera neto e aktiveve të Fondit është e barabartë me totalin e aktiveve minus detyrimet e Fondit.

3.9 Detyrime të shitjes së kuotave

Në momentin e kërkesës për shlyerje kuotash nga investitorët, vlera e kuotave regjistrohet si detyrim financiar dhe mbartet si detyrim i pagueshëm në pasqyrën e pozicionit financiar.

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

3.10 Të ardhurat nga interesa në letra me vlerë

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat e investimeve njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në bazë të metodës së interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare përgjatë jetës së aktivit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme për një periudhë më të shkurtër) në vlerën kontabël të aktivit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset në momentin fillestar të njohjes së aktivit, ose detyrimit financiar dhe nuk ndryshohet në periudhat e mëtejshme.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të marra, kostot e transaksionit, zbritjet apo primet të cilat janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv. Kostot e transaksionit janë kosto shtesë të lidhura me blerjen, emetimin ose çregjistrimin e aktivit, ose detyrimit financiar.

Të ardhurat nga interesat e obligacioneve të thesarit të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave pasqyrojnë interesin e aktiveve financiare të investuara të Fondit.

3.11 Fitim/ humbjet e realizuara

Fitim/humbjet e realizuara krijohen në rastin e shitjes së letrave me vlerë me çmim të ndryshëm nga çmimi i blerjes së letrave me vlerë dhe efektet transferohen në pasqyrën e fitim humbjes në momentin kur ndodhin.

3.12 Fitim/humbjet e parealizuara

Fitim/humbjet e parealizuara krijohen në rastin e vlerësimit të letrave me vlerë me vlerën e tregut, i cili mund të jetë i ndryshëm nga çmimi i blerjes së letrave me vlerë. Kur ndodh shitja e letrave me vlerë, vlera e fitim/humbjeve të parealizuara transferohet në fitim/humbje të realizuara.

3.13 Tarifa e administrimit

Fondi detyrohet t'i paguajë Shoqërisë së Administrimit një tarifë prej 2% (në bazë vjetore) të Vlerës Neto të Aktiveve. Ky shpenzim përllogaritet në bazë ditore.

3.14 Palë të lidhura

Konsiderohen palë të lidhura palët që kanë influencë, kontroll, ndikim në vendimet financiare dhe efekt mbi fitimin apo humbjen, pozitën financiare të Fondit. Palë të lidhura me Fondin është konsideruar edhe Banka Depozitare bazuar në kërkesat për raportim të AMF-së.

4. Strategjia e investimit

Strategjia e investimeve të aktiveve të Fondit ABI FLEX USD mbështetet në ligjin nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" i cili ka hyrë në fuqi në 20 qershor 2020, rregulloret e dala në zbatim të tij, si dhe në politikën e brendshme të investimit të Shoqërisë administruese, propozuar nga Komiteti i Investimit dhe miratuar nga Këshilli i Administrimit i Shoqërisë Administruese. Menaxheri i portofolit ndjek një politikë konservatore duke u fokusuar në menaxhimin e rrezikut të normave të interesit, rrezikut të kredisë dhe rrezikut të likuiditetit. Limitet e aplikuar për çdo rrezik janë të shfaqura në Politikën e Menaxhimit të Rrezikut (PMR). PMR gjithashtu përmban limite për çdo faktor rreziku të cilët kushtëzojnë humbjet e padëshiruara.

Fondi synon optimizimin e normës së kthimit duke minimizuar rrezikun, të kushtëzuar nga qëllimi parësor i ruajtjes së vlerës së kapitalit dhe likuiditetit. Alokimi i aseteve do të jetë kryesisht në obligacione dhe aksione të cilat përmbajnë rrezik minimal të kredisë por janë të ekspozuara ndaj rrezikut nga normat e interesit.

Alokimi strategjik i aktiveve

Alokimi Strategjik i synuar nga Shoqëria, është si me poshte:

	Pesha (Min-Max)	Ekspozimi i aseteve 31.12.2025	Ekspozimi i aseteve 31.12.2024
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	10%	19.61%	19.95%
Tregu i obligacioneve	55%	45.55%	39.64%
Tregu i aksioneve	30%	35.54%	38.15%
Tregu i metaleve të çmuara	5%	-	0%

Shoqëria Administruese e Fondit në çdo moment do të konsiderojë situatat faktike dhe të pritshme në tregjet lokale dhe ndërkombëtare dhe do të përshtasë strategjinë e saj të investimit si dhe alokimin e aseteve në dritën e këtyre ndryshimeve.

Menaxherët e portofolit do të gjykojnë sipas rastit dhe kushteve të tregut dhe mund të devijojnë nga shpërndarja e synuar.

Nuk ka kufizim në lidhje me masën e këtij devijimi, nga shpërndarja e synuar që nënkupton se maksimumi i ekspozimit në secilin treg apo nënkategoritë e përcaktuara në tabelën e shpërndarjes së aktiveve mund të shkojë nga 0% deri në 100%, me kusht që të respektohen në çdo kohë të gjitha kufizimet ligjore të përcaktuara në nenin 139 dhe 140 të ligjit 56/2020 dhe rregulloreve të dala në zbatim të tij.

Kufiri i investimeve të lejuara

Sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike investon, merr dhe jep hua, në përputhje me dispozitat e parashikuara nga aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të Ligjit nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" dhe rregullatori i aprovuar nga Bordi i AMF-së në datën 30.06.2021 "Për investimet, dhëniet dhe marrjet e huave të sipërmarrjeve të investimeve kolektive".

4. Strategjia e investimit (vazhdim)

Tregu i obligacioneve

Fondi synon të investojë në obligacione drejtpërdrejt ose në mënyrë indirekte duke investuar në sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive. Përzgjedhja e investimeve të drejtpërdrejta do të bëhet nga menaxherët e portofolit kryesisht duke patur parasysh yield, vlerësimin e obligacioneve nga agjencitë e vlerësimit të kreditit si edhe likuiditetin apo tregtueshmërinë e tyre në tregjet ndërkombëtare. Fondi mund të investojë një pjesë të konsiderueshme të aseteve në obligacione të vlerësuara si "nën gradë investimi" apo pjesërisht edhe në obligacione të cilat nuk janë të vlerësuara. Kjo strategji investimi ka si synim kryesor të zgjerojë yieldin që përfiton fondi, duke përdorur ndërkohë investime në aktive të tjera me qëllimin e reduktimit të rrezikut të portofolit. Fondi mund të investojë edhe në obligacione të nënrenditura (subordinated) të emetuare nga Banka apo institucione financiare, me synimin e zgjerimit të yieldit total të fondit në një periudhë afatmesme. Në lidhje me investimet në sipërmarrje të tjera të cilat investojnë në obligacione, përzgjedhja e tyre do të bëhet duke marrë parasysh performancën e fondit, vlerësimin/renditjen e aktiveve që ka investuar fondi, eksperiencën e menaxherëve të fondit si edhe procesin e menaxhimit të rrezikut. Këto sipërmarrje mund të jenë ose jo fonde të tregtuara në bursë (ETF).

Tregu i aksioneve

Synimi i investimeve në tregun e aksioneve është maksimizimi i rritjes reale të portofolit në periudhë afatmesme deri afatgjatë, duke marrë një rrezik më të lartë sesa investimet në tregun e titujve të borxhit, dhe duke u ekspozuar ndaj një luhatshmërie më të lartë. Fondi investon në këtë treg në mënyrë direkte duke investuar në aksione individuale apo indirekte duke investuar në kuota apo aksione të sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive që investojnë në këtë klasë aktivesh. Këto fonde janë të mirëdiversifikuara, ato mund të jenë të menaxhuar në mënyrë aktive, ose të jenë të tregtuara në Bursë (ETF). Ekspozimi i tyre mund të jetë global, ose i përqendruar në një rajon apo sektor specifik. Në rastet e investimit në mënyrë indirekte, pesha specifike e secilit fond në portofol ndryshon bazuar mbi pritshmëritë për potencialin e rritjes që kanë menaxherët e fondit por ajo nuk tejkalon më tepër se 10% në një sipërmarrje të vetme. Investimet përzgjidhen kryesisht duke u bazuar në performancën e fondeve, procesin e menaxhimit të rrezikut, si dhe ekspozimin që kanë fondet në një rajon apo sektor specifik. Investimet në fondet e tjera të investimeve përzgjidhen kryesisht duke u bazuar në cilësinë e procesit të investimit, performancën e tyre dhe menaxhimin e rrezikut të tyre.

Tregu i metaleve të çmuara

Fondi synon të investojë një pjesë të vogël të aktiveve të tij në tregun e metaleve të çmuara të tilla si ari, argjendi, platini apo metale të tjera. Ekspozimi i fondit në këtë treg do të arrihet nëpërmjet ekspozimit në sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive të cilat investojnë aktivet e tyre në këto tregje. Këto sipërmarrje mund të jenë sipërmarrje të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur apo fonde të tregtuara në bursë (ETF).

Tregu i parasë dhe ekuivalentë cash-i

Në përgjithësi, një pjesë e vogël e aktiveve mbahet në cash apo ekuivalentë të tij, të tilla si depozita bankare me maturim deri në një vit, si edhe instrumenta të tjerë si marrëveshje të riblerjes/të anasjelltë të riblerjes, si dhe huadhënie titujsh. Qëllimi i përdorimit të investimeve në tregun e parasë, si depozita dhe transaksione të marrëveshjes së riblerjes / të anasjelltë të riblerjes është të mbulojë nevojat e likuiditetit afatshkurtër të Fondit duke përmbushur edhe detyrimet ligjore ndaj investitorëve brenda afateve të përcaktuara. Fondi gjithashtu mund të japë hua titujt që ka në pronësi, me qëllimin e rritjes së fitimeve të fondit, në bazë të një marrëveshje të huadhënies së titujve.

4. Strategjia e investimit (vazhdim)

Kufizime në lidhje me investimet në sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive

Në lidhje me investimet në sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive fondi do të zbatojë kufizimet e përcaktuara nga ligji 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" si në vijim:

- a) Në lidhje me investimet në sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike duhet të përmbushen kushtet e mëposhtme.
- këto sipërmarrje të jenë të licencuara, në një prej vendeve të Bashkimit Evropian, SHBA, Kanada, Zvicër, Britaninë e Madhe, apo Australi nga Autoritetet përkatëse rregullatore
 - këto sipërmarrje nuk investojnë më tepër se 20% të aktiveve të tyre në sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive
 - niveli i mbrojtjes për pjesëmarrësit në këto sipërmarrje të jetë i barasvlershëm me atë që parashikohet për pjesëmarrësit në sipërmarrjen e investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në Republikën e Shqipërisë dhe në veçanti me rregullat për veçimin e aktiveve, huamarrjen, huadhënien dhe shitjen e pambuluar të titujve të transferueshëm dhe instrumenteve të tregut të parasë që janë të barasvlershme me kërkesat e ligjit 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive"
 - veprimtaria e sipërmarrjeve të tjera të raportohet në raportet vjetore dhe të ndërmjetme dhe në pasqyrat financiare për të mundësuar vlerësimin e aktiveve dhe pasiveve, të ardhurave dhe veprimtarisë gjatë periudhës së raportimit

b) *Në lidhje me investimet në sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive të cilat janë UCITS*

Kuotat apo aksionet e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të cilat janë të klasifikuara si UCITS në përputhje me direktivën 2009/65/EC, nuk mund të tejkalojnë më tepër se 30% të aktiveve të fondit.

c) *Në lidhje me kufizimin për investim në një sipërmarrje të vetme*

Fondi nuk investon më tepër se 10% të aktiveve në një sipërmarrje të vetme.

5. Menaxhimi i rrezikut

5.1 Kuadri i Administrimit të Rrezikut

Shoqëria administruese ka krijuar një sistem të administrimit të rreziqeve i cili siguron identifikimin, monitorimin, matjen dhe raportimin në çdo kohë të rreziqeve ndaj të cilave është i ekspozuar Fondi dhe Shoqëria.

Njësia e Administrimit të Rrezikut vepron e pavarur nga njësitë e tjera të Shoqërisë dhe është përgjegjëse për administrimin e rrezikut brenda Shoqërisë. Menaxheri i Rrezikut kryen identifikimin, matjen dhe kontrollin si sasior dhe cilësor të risqeve dhe bën menaxhimin dhe raportimin e tyre. Ai kontrollon aktivitetin e Menaxherit të Portofolit në mënyrë që të merren vendimet e duhura për investimet në përputhje me rrezikun ekzistues të portofolit dhe jep rekomandime për mbajtjen e niveleve të përshtatshme të rrezikut brenda kufijve të përcaktuar. Menaxheri i Rrezikut kryen provat e rezistencës në kushte normale dhe në kushte të stresuara të tregut me qëllim monitorimin e ecurisë së fondit dhe treguesit të likuiditetit.

5 Menaxhimi i rrezikut (vazhdim)

5.1 Kuadri i Administrimit të Rrezikut (vazhdim)

Politika e Menaxhimit të Rrezikut udhëhiqet nga natyra e Fondit si edhe tolerancës për rrezik e përcaktuar në objektivat e investimit të Fondit. Shoqëria administruese ka rishikuar së fundmi politikat e menaxhimit të rrezikut dhe procedurat e fondit me qëllim që të përshtatet me kërkesat e ligjit 56/2020 dhe rregulloret e reja të aprovuara nga AMF.

a) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i humbjes nga luhatjet në vlerën e tregut të pozicioneve të portofolit të Fondit që lidhen me ndryshimet në variablat e tregut, siç janë normat e interesit, kurset e këmbimit valutor, apo klasifikimi i rrezikut të kreditit të emetuesit.

Çmimet e instrumenteve financiare varen kryesisht nga zhvillimet në tregjet e kapitalit të cilat nga ana tjetër ndikohen nga situata e përgjithshme ekonomike dhe politike e shteteve. Një formë e rrezikut të tregut është rreziku nga normat e interesit.

b) Rreziku nga normat e interesit

Çmimet e obligacioneve dhe normat e interesave janë të lidhura në mënyrë të kundërt. Nëse normat e interesave rriten, vlera e instrumenteve me të ardhura fikse (obligacionet, bonot) pëson ulje. Asetet me kohëzgjatje më të madhe janë shumë më sensitive se asetet me kohëzgjatje më të ulët. Për rrjedhojë vlera e tyre pëson luhatje më të mëdha.

Tabela më poshtë paraqet ndikimin në të ardhurat neto nga interesi si pasojë e një ndryshimi të kurbës së interesit me 100 bp për portofolin e titujve me të ardhura fikse:

Skenari
+ 100 bp

31 dhjetor 2025
Efekti në fitim/humbje
(146,009)

Kohëzgjatja e modifikuar për fondin me 31.12.2025 është 0.55.

c) Rreziku i kredisë

Fondi humbet nëse emetuesi i ndonjë obligacioni apo bonoje nuk është i gatshëm apo nuk shpreh vullnetin për të paguar interesin apo principalin në kohë. Përzgjedhja me kujdes e investimeve nuk e eviton mundësinë e humbjes kur emetuesi është në paaftësi paguese apo ka pasur humbje në aktivitetet e tij operacionale. Obligacionet dhe bonot përmbajnë një spektër gradash të rrezikut të kredisë, i cili reflektohet në "rating" (notat e kreditit) e tyre. Fondi do të investojë kryesisht në tituj të Republikës së Shqipërisë dhe për rrjedhojë është i lidhur ngushtë me aftësitë paguese të Shtetit Shqiptar.

d) Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Fondi emeton dhe shlyen kuota në monedhën USD. Në rast të investimeve në monedha të ndryshme nga monedha e Fondit, një formë tjetër e rrezikut të tregut është rreziku i kursit të këmbimit, i cili shpreh mundësinë që zhvlerësimi i monedhës të ndikojë negativisht vlerën e aseteve të fondit. Deri në datën e raportimit, Fondi ka investuar vetëm në monedhën USD, pra ka shmangur ekspozimin me këtë rrezik.

5 Menaxhimi i rrezikut (vazhdim)

5.1 Kuadri i Administrimit të Rrezikut (vazhdim)

e) Rreziku Operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjes nga procedura të brendshme të papërshtatshme dhe nga mosfunksionimi në lidhje me sistemet dhe stafin e shoqërisë administruese ose palës së lidhur e cila kryen disa funksione të deleguara për shoqërinë administruese, ose që rezulton nga ngjarje të jashtme dhe që përfshin risqe ligjore, risqe dokumentacioni dhe risqe që rezultojnë nga procedurat e tregtimit shlyerjes dhe vlerësimit, të cilat zbatohen nga fondi.

f) Rreziku Ligjor

Rreziku ligjor përbën rrezikun e humbjeve që lindin për shkak të çështjeve ligjore të shkaktuara nga paaftësia e shoqërisë administruese për të zbatuar kontratat ligjore, licencat dhe/ose të drejtat e pronësisë.

g) Rreziku Politik

Rreziku politik asociohet me ndryshimin në ambientin politik i cili mund të ketë impakt negativ në të gjithë bizneset e vendit. Njëkohësisht vlerësimet për një mungesë stabiliteti politik në vend, edhe sipas vlerësimeve të jashtme të agjensive të kreditimit, mund të ndikojnë në rritjen e kostove të borxhit dhe rritje të normave të interesit në treg të cilat ndikojnë në çmimin e aseteve të Fondit.

h) Rreziku i Agjencisë

Rreziku i Agjencisë është dëmi që mund t'i shkaktohet fondit nga vendimarrja e qëllimshme të drejtuesve të shoqërisë administruese ose drejtuesve të fondit, për interesa personale dhe në kundërshtim me interesat e investitorëve të fondit. Për të parandaluar këto veprime, Shoqëria Administruese ka përpiluar politika dhe procedura të brendshme dhe ka vendosur mekanizmat e nevojshëm të kontrollit të brendshëm.

i) Rreziku i Reputacionit

Rreziku i reputacionit konsiston në perceptimin e publikut në lidhje me besueshmërinë e Fondit dhe Shoqërisë Administruese, duke përfshirë ndikimin e ngjarjeve specifike të cilat mund të përkeqësohen ose ndikojnë negativisht në perceptimin e publikut. Humbja e reputacionit mund të shkaktojë humbje të të ardhurave dhe rënie të aktiveve të Fondit.

j) Rreziku rregullator

Rreziku rregullator nënkupton paqartësinë dhe pasigurinë që shoqërojnë ndryshimet të kuadrit rregullator e cila ndikon mbi performancën e fondit.

k) Rreziku i shlyerjeve të mëdha

Shlyerja e shumëve të mëdha mund të ketë impakt negativ në performancën e Fondit, sepse amplifikon humbjet që mund të vijnë nga shitja e pafavorshme e një instrumenti financiar, me pasojë rënie të çmimit të kuotës.

5 Menaxhimi i rrezikut (vazhdim)

5.1 Kuadri i Administrimit të Rrezikut (vazhdim)

l) Rreziku i shlyerjeve të mëdha

Shlyerja e shumave të mëdha mund të ketë impakt negativ në performancën e Fondit, sepse amplifikon humbjet që mund të vijnë nga shitja e pafavorshme e një instrumenti financiar, me pasojë rënie të çmimit të kuotës.

m) Rreziku i vlerësimit të asetëve

Për shkak të tregjeve jo likuide Fondi vlerëson asetet e tij sipas 'marking-to-model', që nënkupton përdorimin e shumë supozimeve. Në rastet kur investitorët mund të kërkojnë të tërheqin kuotat e tyre në të njëjtën kohë, Fondi mund të jetë i detyruar të shesë letra me vlerë nga portofoli i tij, me një çmim të ndryshëm nga çmimi i vlerësimit të tyre.

n) Rreziku i personelit kyç

Në ecurinë e fondit, kontribut të konsiderueshëm ka aftësia intelektuale dhe profesionale e personave apo funksioneve përgjegjës dhe personelit kyç, përfshirë veprimet dhe vendimmarrjet e përshtatshme të Këshillit të Administrimit ose menaxherëve të fondit. Gjatë jetës së fondit, përbërja e personelit të shoqërisë apo organigramës së saj mund të ndryshojë me pasojë performancë më të ulët të realizimit të detyrave. Kjo performancë profesionale më e ulët mund të impaktojë në vendimmarrje më pak efikente në investime e si rrjedhim në një përfitueshmëri më të ulët për investitorët

o) Rreziku i pezullimit të shlyerjes së kuotave

Në parim, investitori mund të kërkojë në çdo moment shlyerjen e kuotave të Fondit. Megjithatë, Shoqëria Administruese apo AMF mund të pezullojë përkohësisht shlyerjen e kuotave, në rastet e parashikuara në Ligj.

p) Rreziku i përqendrimit

Fondi do të investojë kryesisht në letra me vlerë të emetuara nga Republika e Shqipërisë, dhe për rrjedhojë portofoli nuk është i mirë-diversifikuar. Stabiliteti ekonomik dhe politik apo çdo problematikë e fokusuar vetëm të Shteti Shqiptar, e cila mund të përkeqësojë aftësitë paguese të Shtetit Shqiptar, rrezikon dhe e bën të pambrojtur performancën e fondit.

q) Rreziku i Likuiditetit

Rreziku i likuiditetit ekziston në ato kushte kur disa asete bëhen shumë të vështira për t'u shitur apo për tu blerë. Investimi i fondit në asete jo-likuide mund të sjellë ulje të normës së kthimit pasi mund të bëhet e pamundur shitja e këtij aseti në një kohë të përshtatshme apo me një çmim që rezulton me fitim. Tregu sekondar i letrave me vlerë të Qeverisë Shqiptare konsiderohet treg jo likuid me aktivitet të kufizuar.

r) Rreziku i depozitarit

Funksioni i depozitarit kryhet nga një subjekt i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Megjithatë, për një arsye apo një tjetër, kjo shoqëri nuk mund të përmbushë detyrimet e saj ligjore, dhe në këtë rast disa aktivitete të fondit, si për shembull regjistrimi i asetëve të Fondit apo, përllogaritja e vlerës neto të asetëve, mund të vonohen.

FONDI I INVESTIMIT "ABI FLEX USD"

Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

5. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

5.1 Kuadri i Administrimit të Rrezikut (vazhdim)

s) Rreziku i likuiditetit

31 dhjetor 2025	Vlera kontabël	Flukset monetare kontraktuale	Më pak se 1 muaj	3 - 6 muaj	6 - 12 muaj	1 - 5 vjet	> 5vjet
Aktivët monetare							
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	12,711,326	-	12,711,326				
Investime në letra me vlerë	52,427,105	-	27,569,227	2,844,897	3,292,562	14,408,587	1,847,006
Total	65,138,431	-	40,280,553	2,844,897	3,292,562	14,408,587	1,847,006
Detyrimet monetare							
Detyrime ndaj Shoqërisë	207,499	-	207,499	-	-	-	-
Administruese	244,486	-	244,486	-	-	-	-
Detyrime të tjera	451,985	-	451,985	-	-	-	-
Total	64,686,446	-	39,828,568	2,844,897	3,292,562	14,408,587	1,847,006
Pozicioni neto	-		42,293,395	45,138,291	48,430,853	62,839,440	64,686,446
Efekti akumuluar							

31 dhjetor 2024	Vlera kontabël	Flukset monetare kontraktuale	Më pak se 1 muaj	1 – 3 muaj	3 - 6 muaj	6 - 12 muaj	1 - 5 vjet	> 5vjet
Aktivët monetare								
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	14,920,456		14,920,456		-	-	-	-
Investime në letra me vlerë	50,463,158		24,157,048	15,202,521	4,403,378	6,700,212	-	-
Total	65,383,614	-	39,077,503	-	15,202,521	4,403,378	6,700,212	-
Detyrimet monetare								
Detyrime ndaj Shoqërisë	107,848		107,848	-	-	-	-	-
Administruese	2,099,998		2,099,998	-	-	-	-	-
Detyrime të tjera	2,207,845	-	2,207,845	-	-	-	-	-
Total	63,175,769	-	36,869,658	-	15,202,521	4,403,378	6,700,212	-
Pozicioni neto			36,869,658	36,869,658	52,072,179	56,475,556	63,175,769	63,175,769
Efekti akumuluar								

FONDI I INVESTIMIT “ABI FLEX USD”**Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare***(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***6. Paraqitja e vlerës së drejtë**

Vlera e drejtë është çmimi që do të merret për të shitur një aktiv ose të paguar për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes.

Kur është e mundur, Fondi mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Tregu konsiderohet si aktiv nëse çmimet e kuotuar janë të disponueshme në mënyrë të gatshme dhe të rregullt dhe përfaqësojnë transaksione aktuale dhe rregullisht të ndodhura në treg në bazë të gjerësisë së krahut.

Nëse një treg për një instrument financiar nuk është aktiv, Fondi përcakton vlerën e drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë përdorimin e transaksioneve të kohëve të fundit në mes të palëve të ndryshme në mënyrë të vullnetshme, referencën ndaj vlerës së drejtë të instrumenteve të tjerë që janë në thelb të njëjtë, analizat e skontuara të flukseve monetare dhe modelet e çmimeve.

Mjete monetare dhe ekuivalentë – Mjetet monetare në bankë janë afatshkurtra dhe me interesa të luhatshëm, vlera e tyre e drejtë konsiderohet e përafërt me vlerën kontabël.

Letrat me vlerë – Investimet në letra me vlerë përfshijnë investime në bono thesari dhe obligacione qeveritare.

Metoda e njohjes së vlerës së drejtë e përdorur nga fondi është metoda e “mark to model” duke përdorur interesin e interpeluar të ankandëve të fundit të emetimeve qeveritare. Të dhënat e përdorura për llogaritjen e vlerës së drejtë janë niveli 3.

	Niveli të dhënave	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	3	12,711,326	14,920,456
Investime në letra me vlerë		52,427,105	50,246,917
Totali i aktivit		65,138,431	65,167,373

7. Mjete Monetare dhe ekuivalente të tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to janë të përbëra si më poshtë:

	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2024
Llogari në banka në Lek	94,946	3,609,256
Depozita afatshkurtrë	12,616,380	11,311,200
Total	12,711,326	14,920,456

Depozitat afatshkurtra konsistojnë në depozita të vendosura si më poshtë:

	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2024
ABI Bank	3,133,480	-
Credins Bank	9,482,900	-
FIB Bank	-	11,311,200
Total	12,616,380	11,311,200

FONDI I INVESTIMIT "ABI FLEX USD"**Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare***(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***8. Investime në letra me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes**

Investimet në letra me vlerë përfaqësojnë aktive financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes në bono thesari dhe obligacione qeveritare përgjatë 2025 dhe 2024:

	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2024
Kuota të fondeve të investimit	10,501,619	13,618,113
Obligacione qeveritare	23,101,598	21,032,831
Tituj të emetuar nga Korporata të Huaja	3,292,562	5,572,142
Investime në aksione	15,531,325	10,023,831
Totali	52,427,105	50,246,917

Paraqitja e vlerës së drejtë të këtyre letrave me vlerë është si më poshtë:

	31 dhjetor 2025			
	Vlera e blerjes	Interesi i përlogaritur	Humbje nga vlera e drejtë	Vlera e drejtë
Kuota të fondeve të investimit	9,149,363	-	1,352,256	10,501,619
Investime në aksione të zakonshme	22,817,102	142,073	284,497	23,243,671
Obligacione qeveritare	3,229,975	10,869	62,587	3,303,431
Obligacione Korporatash	13,082,856		2,448,469	15,531,325
Totali	48,279,296	152,94-2	4,147,809	52,580,046

9. Detyrimi ndaj shoqërisë administruese

	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2024
Detyrime ndaj shoqërisë administruese	207,499	107,848
Totali	207,499	107,848

10. Detyrime të tjera

	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2024
Detyrime tarife auditi	234,840	172,943
Detyrime tarife depozitari	4,407	10,785
Tarife agjenti	5,240	2,729
Detyrime të tjera	0	1,913,541
Totali i detyrimeve	244,486	2,099,998

FONDI I INVESTIMIT "ABI FLEX USD"
Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)

11. Fitim/Humbje të përealizuara nga maturimi i investimeve dhe të tjera

	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2024
Fitimet/ Humbjet (neto) të përealizuara nga Investimet kuota të fondeve të investimit	1,352,256	1,778,516
Fitimet/ Humbjet (neto) të përealizuara nga obligacionet Qeveritare	284,497	(245,432)
Fitimet / Humbjet (neto) të përealizuara nga Investimet në aksione të zakonshme	2,448,469	97,653
Fitimet / Humbje (neto) të përealizuara nga obligacionet e Korporatave	62,587	240,607
Totali	4,147,809	1,871,344

12. Të ardhura nga interesa të tjerë

	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2024
Të ardhura interesi nga interesat e kuponëve të obligacionet e Korporatave	-	208,888
Të ardhura interesi nga interesat e kuponëve të obligacionet Qeveritare	379,375	643,974
Të ardhura interesi nga depozita	593,368	497,918)
Totali	972,743	1,350,779

13. Tarifa për shoqërinë administruese

	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2024
Tarifa e menaxhimit të shoqërisë administruese	1,215,816	1,197,847
Totali	1,215,816	1,197,847

14. Tarifa për depozitarin

	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2024
Tarifë depozitari	121,134	119,791
Tarifë transaksioni për depozitarin	17,559	12,129
Totali	138,693	131,920

15. Shpenzime të tjera

	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2024
Tarifë auditi	242,902	170,754
Tarifa agjenti	30,734	30,391
Shpenzime të tjera	204,914	179,714
Humbjet e transaksioneve spot të maturuara	-	40
Totali	478,550	380,899

FONDI I INVESTIMIT “ABI FLEX USD”**Shënime Shpjeguese për Pasqyrat Financiare***(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveçse kur është shprehur ndryshe)***16. Fitim/ (Humbje) nga kursi i këmbimit**

	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2025	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2024
Diferenca pozitive të kurseve të këmbimit	17,766,863	18,522,069
Diferenca negative të kurseve të këmbimit	(23,654,731)	(18,199,663)
Totali	(5,887,868)	322,406

17. Transaksione me palë të lidhura

Palët konsiderohen të lidhura kur njëra ka aftësinë të kontrollojë apo të ushtrojë një influencë të konsiderueshme mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operacionale, apo palët janë nën kontroll të përbashkët me Fondin.

Banka depozitare konsiderohet palë e lidhur bazuar në rregulloren “Mbi përmbajtjen e detyrueshme, afatet dhe formën e raporteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, shoqërive të administrimit dhe depozitarëve.

Balancat në fund të periudhës me palët e lidhura paraqiten si më poshtë:

				31 dhjetor 2025
	Aktive	Detyrime	Të ardhura	Shpenzime
Credins Bank	9,577,846	4,406		4,406
Banka e Parë e Investimeve Sha	-	-	-	134,286
ABI Bank	3,113,480	-	-	-
ABI Invest	-	207,499	-	1,215,816
	Aktive	Detyrime	Të ardhura	31 dhjetor 2024
				Shpenzime
Banka e Parë e Investimeve Sha	3,609,256	-	-	131,920
ABI Bank	11,311,200	-	-	-
ABI Invest	-	291,575	-	1,197,847

18. Ngjarje pas datës së raportimit

Drejtimi i Shoqërisë nuk është në dijeni të ndonjë ngjarjeje pas datës së raportimit që do të kërkonte korrigjime apo shënime sqaruese në pasqyrat financiare.

Fondi i investimit "ABI Flex USD"**Skedule suplementare të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2025***(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***SKEDULE SUPLEMENTARE – I****Pasqyra e Treguesve të Veçantë**

	Për periudhën 1 Janar deri 31 dhjetor 2025	Për periudhën 1 Janar deri 31 dhjetor 2024
Vlera e aktiveve neto	64,843,753	63,175,769
Numri i kuotave të Fondit	6,886	6,345
Vlera neto e aktiveve për kuotë	9,416.7505	9,957.2340
Numri i kuotave të Fondit në fillim të periudhës	6,345	5,742
Numri i kuotave të Fondit të emetuara	541	660
Numri i kuotave të Fondit të shlyera		57
Numri i kuotave të Fondit në fund të periudhës	6,886	6,345
Raporti ndërmjet kostos dhe aktiveve neto mesatare vjetore	3.01	2.86
Raporti ndërmjet të ardhurave neto dhe aktiveve neto mesatare/Fitim i paguar për kuote	-5.67	4.15
Raporti i kthimit të aktiveve të fondit	8.11	3.97
Vlera më e ulët e vlerës neto të aseteve për kuotë	8,893	9,326
Vlera më e lartë e vlerës neto të aseteve për kuotë	10,312	10,067
Vlera më e ulët e vlerës neto të aseteve	65,524,351	54,800,930
Vlera më e lartë e vlerës neto të aseteve	57,009,690	63,823,884

Fondi i investimit "ABI Flex USD"
Skedule suplementare të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2025
(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)
SKEDULE SUPLEMENTARE – II
Pasqyra e strukturës së investimeve më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024

Përshkrimi	Vlera nominale	Çmimi i blerjes	Vlera kontabël	31/12/2025 % Aktiveve të Fondit
Obligacione qeveritare	26,650,000	23,733,516	23,101,598	35%
Obligacione të shoqërisë	-	3,692,183	3,292,562	5%
Aksione të zakonshme	-	14,398,393	15,531,325	24%
Kuota të fondeve të investimit	-	10,458,634	10,501,619	16%
Asete të tjera	--	-	157,308	0%
Mjete monetare dhe ekuivalentë	-	-	12,711,326	19%
TOTALI		52,282,726	65,295,738	100%

Lloji	Vlera nominale	Kostoja e prokuruar	Vlera në datën e raportimit	Pjesëmarrja në totalin e aktiveve të fondit,%
Obligacione të Qeverisë (brenda vendit) treg primar	-	-	-	-
Obligacione të Qeverisë (brenda vendit) treg sekondar	-	23,101,598	23,101,598	44%
Totali i obligacioneve të emetuesve vendas	-	23,101,598	23,101,598	44%
Obligacione të shoqërisë			3,292,562	6%
Aksione të zakonshme	-	-	15,531,325	30%
Kuota të fondeve të investimit	-	-	10,501,619	20%
Bono të thesarit (brenda vendit) treg primar	-	-	-	-
Bono të thesarit (brenda vendit) treg sekondar	-	-	-	-
Totali i bonove të thesarit (brenda vendit)	-	-	-	-
TOTALI	0	23,101,598	52,427,104	100%

Fondi i investimit "ABI Flex USD"**Skedule suplementare të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2025***(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***Pasqyra e strukturës së investimeve më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 (Vazhdim)**

Përshkrimi	31/12/2024			% Aktiveve të Fondit
	Vlera nominale	Çmimi i blerjes	Vlera kontabël	
Obligacione qeveritare	21,208,500	20,762,962	21,032,831	32.17%
Obligacione të korporatave	5,655,600	5,450,859	5,572,142	8.52%
Asete të tjera	-	-	23,641,943	36.16%
Mjete monetare dhe ekuivalentë	-	-	15,136,697	23.15%
TOTALI	26,864,100	26,213,821	65,383,614	100%

Lloji	Vlera nominale	Kostoja e prokuruar	Vlera në datën e raportimit	Pjesëmarrja në totalin e aktiveve të fondit, %
Obligacione të Qeverisë (brenda vendit) treg primar	-	-	-	-
Obligacione të Qeverisë (brenda vendit) treg sekondar	-	26,604,973	26,604,973	53%
Totali i obligacioneve të emetuesve vendas	-	26,604,973	26,604,973	53%
Aksione të zakonshme			10,023,831	20%
Kuota të fondeve të investimit			13,618,113	27%
Bono të thesarit (brenda vendit) treg primar	-	-	-	-
Bono të thesarit (brenda vendit) treg sekondar	-	-	-	-
Totali i bonove të thesarit (brenda vendit)	-	-	-	-
TOTALI	-	26,604,973	50,246,917	100%

Fondi i investimit "ABI Flex USD"**Skedule suplementare të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2025***(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***SKEDULE SUPLEMENTARE – III****Pasqyra e (fitimeve)/humbjeve të realizuara të fondit për periudhën deri më 31 dhjetor 2025 dhe deri më 31 dhjetor 2024**

				31 dhjetor 2025
	Shuma apo Vlera	Vlera	Çmimi i	Fitimi/ (Humbja) e
Letra me vlerë të shitura	Nominale	kontabël/e	shitjes	realizuar
Obligacione të Qeverisë	305,000	27,187,708	26,151,350	(1,036,358)
Aksione të zakonshme	270	947,002	1,549,525	602,523
Obligacione të Shoqërisë	20,000	1,879,959	1,704,503	(175,456)
Kuota te fondeve tre investimit	444	3,159,478	2,732,093	(427,385)
Totali i humbjeve të realizuar	325,714	33,174,147	32,137,471	(1,036,676)

				31 dhjetor 2024
	Shuma apo Vlera	Vlera	Çmimi i	Fitimi/ (Humbja) e
Letra me vlerë të shitura	Nominale	kontabël/e	shitjes	realizuar
Obligacione të Qeverisë	180,000.00	16,752,511	16,736,000	(16,511)
Aksione të zakonshme	473	3,139,693	3,608,677	468,985
Bono Thesari			-	-
Kuota te fondeve tre investimit			-	-
Totali i humbjeve të realizuar	180,473	19,892,204	20,344,677	452,474

Fondi i investimit "ABI Flex USD"**Skedule suplementare të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2025***(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***SKEDULE SUPLEMENTARE – IV****Pasqyra e Humbjeve të përealizuara të fondit për periudhën deri më 31 dhjetor 2025 dhe deri më 31 dhjetor 2024**

31/12/2025			Fitimi i përealizuar nga ndryshimi i çmimit, i njohur drejtpërsëdrejti përmes fitimit/(humbjes)
Instrumentet financiare (*)	Vlera e blerjes	Vlera kontabël/ e drejtë	
Obligacione të shoqërive	3,692,183	3,292,562	62,587
Obligacione të Qeverisë treg primar	-	-	-
Obligacione të Qeverisë treg sekondar	23,733,516	23,101,598	284,497
Obligacione totale			
Aksione të zakonshme	14,398,393	15,531,325	2,448,469
Kuota të fondeve të investimit	10,458,634	10,501,619	1,352,256
Bono të thesarit treg primar			
Bono të thesarit treg sekondar			
Bono të thesarit total			
Total Bono dhe Obligacione			
Totali Humbjes të përealizuar nga aktive financiare me vlerë të drejtë	52,282,726	52,427,105	4,147,809

31/12/2024			Fitimi i përealizuar nga ndryshimi i çmimit, i njohur drejtpërsëdrejti përmes fitimit/(humbjes)
Instrumentet financiare (*)	Vlera e blerjes	Vlera kontabël/ e drejtë	
Obligacione të shoqërive	5,450,859	5,572,142	97,653
Obligacione të Qeverisë treg primar	-	-	-
Obligacione të Qeverisë treg sekondar	20,762,962	21,032,831	240,607
Obligacione totale	26,213,821	26,604,973	338,260
Aksione të zakonshme	10,247,482	10,023,831	(245,432)
Kuota të fondeve të investimit	11,765,034	13,618,113	1,778,516
Bono të thesarit treg primar	-	-	-
Bono të thesarit treg sekondar	-	-	-
Bono të thesarit total	-	-	-
Total Bono dhe Obligacione	-	-	-
Totali Humbjes të përealizuar nga aktive financiare me vlerë të drejtë	48,226,337	50,246,917	1,871,344

Fondi i investimit "ABI Flex USD"**Skedule suplementare të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2025***(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***SKEDULE SUPLEMENTARE – V****Pasqyra e pozicionit të palëve të lidhura më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024**

Emri i palës së lidhur	Aktive	Detyrime	Të ardhura	31 dhjetor 2025
				Shpenzime
Shoqëria e administrimit		207,499		1,215,816
Banka Depozitare	94,946	4,407		
Ekspert kontabël		242,902		
Institucion krediti/investitor	12,616,380			

Emri i palës së lidhur	Aktive	Detyrime	Të ardhura	31 dhjetor 2024
				Shpenzime
Shoqëria e administrimit	-	107,848	-	1,197,847
Banka Depozitare	3,609,256	10,785	-	
Ekspert kontabël	-	172,943	-	
Institucion krediti/investitor	11,311,200	-		

Fondi i investimit "ABI Flex USD"**Skedule suplementare të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2025***(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***SKEDULE SUPLEMENTARE – VI****Pasqyra e transaksioneve me palë të lidhura për periudhën deri më 31 dhjetor 2025 dhe deri më 31 dhjetor 2024**

Emri i palës së lidhur	Përshkrimi i transaksionit	31 dhjetor 2025		Vlera e transaksionit	(Fitimi)/ Humbja e realizuar
		Vlera nominale	Kosto e blerjes		
Shoqëria e administrimit	Detyrime tarife				
Banka					
Depozitare	Komisione				
Banka					
Depozitare	Tarife				
Banka	Vendosje				
Depozitare	depozite				
Institucion krediti	-				
Institucion krediti	Vendosje				
(ABI BANK)	depozite				

31 dhjetor 2024

Shoqëria e administrimit	Detyrime tarife
Banka	
Depozitare	Komisione
Banka	
Depozitare	Tarife
Banka	Vendosje
Depozitare	depozite
Institucion krediti	-
Institucion krediti	Vendosje
(ABI BANK)	depozite
Shoqëria e administrimit	Detyrime tarife
Banka	
Depozitare	Komisione

Fondi i investimit "ABI Flex USD"**Skedule suplementare të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2025***(të gjitha shumat janë shprehur në Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)***SKEDULE SUPLEMENTARE – VII****Pasqyra e strukturës së detyrimeve financiare për periudhën deri më 31 dhjetor 2025 dhe deri më 31 dhjetor 2024**

31 dhjetor 2025				
Pozicioni	Kosto në vendosje	Vlera në datën e raportimit	Përqindja në asetet neto të sipërmarrjes %	Përqindja në detyrimet e sipërmarrjes %
Detyrime ndaj shoqërisë administruese		207,499		0.5%
Detyrime nga investimi blerje letra me vlerë		-		-
Detyrim ndaj kuota mbajtësve		-		-
Detyrim ndaj ekspertit		-		-
Detyrim ndaj depozitarit		4,407		-
Detyrim ndaj AMF		-		-
Detyrime të tjera		240,080		0.5%
TOTALI		451,986		1%

31 dhjetor 2024				
Pozicioni	Kosto në vendosje	Vlera në datën e raportimit	Përqindja në asetet neto të sipërmarrjes %	Përqindja në detyrimet e sipërmarrjes %
Detyrime ndaj shoqërisë administruese	-	107,848	-	-
Detyrime nga investimi blerje letra me vlerë	-	-	-	-
Detyrim ndaj kuota mbajtësve	-	-	-	-
Detyrim ndaj ekspertit	-	-	-	-
Detyrim ndaj depozitarit	-	10,785	-	-
Detyrim ndaj AMF	-	-	-	-
Detyrime të tjera	-	2,089,212	-	-
TOTALI	-	2,207,845	-	3%